



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Mars 2024

Data 27.03.2024 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

- 1.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2024.
- 2.Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.
- 3.Projekt vendim për miratimin e tavaneve përgaditore të shpenzimeve të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.
- 4.Projekt vendim për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Vau Dejës.
- 5.Projekt vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2024.
- 6.Projekt vendim për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.442 ha, për agropylltari, në ngastren nr.14 të ekonomisë pyjore Drin Gjader Kirë.
- 7.Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore dhe për veprimtari turistike, kampingje(kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe,ngastra nr.108.
- 8.Raport i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2023 i Bashkisë Vau Dejës si dhe raporti i monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.
- 9.Të ndryshme.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Mars 2024, u zhvillua me datë 27.03.2024 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.

Të pranishëm në sallë ishin 16 këshilltarë, korum i mjaftueshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Ervis Shimaj-kryetar i këshillit bashkiak i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi. Z. Ervis Shimaj e hedh në votim rendin e ditës: **Miratohet me 16 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e parë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Shkurt 2024.

Në këtë moment merr pjesë në mbledhje edhe këshilltarja Znj. Leonora Prenga dhe për rrjedhojë bëhen prezent në sallë 17 këshilltarë.

Z. Ervis Shimaj i jep fjalën Znj.Ilda Prendi-perfaqesuese e zyres se ndihmes ekonomike,e cila relatton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar ne fondet e kushtëzuara për muajin Shkurt 2024, perfitojne 135 familje, me 477.757 leke, me 5.98% e fondit total. Në total për Bashkinë Vau Dejës, për muajin Shkurt 2024 janë shpallur fitues, 1045 familje, me fond 7.967.367 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 478.042 lekë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim për ndryshimin e VKB nr.91 datë 21.12.2023 “Miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe PBA përfundimtar 2024-2026, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës”.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Renato Doda-përgjegjes i zyres finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës i cili spjegon se projekt vendimi i paraqitur është përmirësimi i vkb 91/2023.Projekt vendimi është hartuar konform ligjit dhe VKM-ve, nga ku Bashkia Vau Dejes për vitin 2024 vazhdon të mbështesë politikat e ndermarra për ruajtjen e nivelit ekonomik.Projekt vendimi perfshin disa investime të financuara nga buxheti i shtetit dhe nga te ardhurat e Bashkisë.Në projekt vendim paraqiten investimet që do pakësohen si dhe investimet te cilat do te shtohen gjatë vitit buxhetor 2024.Për këtë qëllim është realizuar edhe degjese publike me grupet e interesit me datë 25.03.2024 pranë Nj.A Bushat nga ku ka rezultuar dakortesia e të pranishmëve që të miratohen ndryshimet e propozuar për investimet e vitit 2024.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tretë të rendit të ditës:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Projekt vendim për miratimin e tavanëve përgaditore të shpenzimeve të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Renato Doda-përgjegjes i zyrës financë buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës i cili spjeron se tavanet buxhetore të shpenzimeve për vitin 2025 dhe tavanet e programit buxhetor afatmesëm 2025-2027 janë hartuar konform ligjit.Z.Doda relaton lidhur me parashikimin e të ardhurave sipas zërave për PBA 2025-2027 të cilat parashikohen në rritje nga viti në vit, gjithashtu spjeron edhe tavanet përgaditore të shpenzimeve të PBA 2025-2027 për Bashkinë Vau Dejës sipas transfertave të pakushtezuara, transfertave të pakushtezuara sektoriale, transfertave të kushtezuara.Z.Doda spjeron shpenzimet për vitet 2025-2027 sipas programeve të Buxhetit.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e programit të transparencës në Bashkinë Vau Dejës.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Arion Prenga- përgjegjes -përgjegjes sektori të medias, statistikes dhe TIK, i cili spjeron se projekt vendimi i paraqitur për shqyrtim është hartuar konform ligjeve si dhe urdherit të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, Ky projekt vendim i shërben garantimit të së drejtës së informimit nga ana e Bashkisë e cila ka detyrim vendosjen në dispozicion të çdo qytetari informacionet pa pagesë si dhe aksesin e plotë dhe cilësorë që prodhohen nga administrata e bashkisë.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim për miratimin e planit të masave për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në fondin Pyjor e Kullosor për vitin 2024.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyrës pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se hartimi i projekt vendimit ishte bazuar në ligj dhe se për këtë vit është i nevojshëm dhe i domosdoshëm miratimi i këtij projekt vendimi respektimi i të cilit çon në zvogelimin e rrishtit, mbrojtjen e fondit pyjorë nga zjarret e mundshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e gjashtë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore prej 0.442 ha, për agropylltari, në ngastren nr.14 të ekonomisë pyjore Drin Gjader Kirë.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 20.03.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Stajka nga ana e Këshillit Bashkiak dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin. Këshilli Bashkiak ka kompetencë që të vlerësojë dhënien apo jo në përdorim të pronave të Bashkisë.

Për sipërfaqen e mesiperme e cila do të nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për percaktimin e zonës, distancës dhe gjeresisë të brigjeve dhe burimeve ujore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikes III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 16 vota Pro**, Z. Robert Trushi nuk mori pjesë në votim(pa spjegim).

Z.Ervis Shimaj lexon piken e shtatë të rendit të ditës:

Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat deri në 9 vjet sipërfaqen pyjore prej 2.02 ha, për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetësore dhe për veprimtari turistike, kampingje(kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj) në ekonominë pyjore Gomsiqe, ngastra nr.108.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Mark Suli-inxhinjer specialist pranë zyres pyjeve dhe kullotave, Bashkia Vau Dejës, i cili spjeron për këshilltarët se është zbatuar me korrektesi baza ligjore për hartimin e projekt vendimit dhe se me date 05.03.2024 është realizuar dëgjese publike me banorët e fshatit Gomsiqe dhe se te pranishmit kishin shprehur dakortesi për projekt vendimin me propozimin e sistemimit të hartës ku bën pjesë kjo sipërfaqe pyjore pa ndryshuar sipërfaqen gjë e cila është plotësuar nga ana jonë. Këshilli Bashkiak ka kompetencë që të vlerësojë dhënien apo jo në përdorim të pronave të Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Për sipërfaqen e mesiperme e cila do ti nënshtrohet procedurës së konkurrimit publik, sipas legjislacionit në fuqi është zbatuar VKM nr.748 datë 01.12.2022 “për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjeresisë të brigjeve dhe burimeve ujore”, e cila ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5, si dhe VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për miratimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Ervis Shimaj e hedh në votim projekt vendimin: **Miratohet me 17 vota Pro.**

Z.Ervis Shimaj lexon piken e tetë të rendit të ditës:

Raport i vetëvlerësimit për situatën e gjendjes financiare Janar-Dhjetor 2023 i Bashkisë Vau Dejës si dhe raporti i monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Fjala për të relatuar i jepet Z.Renato Doda-përgjegjes i zyrës finance buxhetit pranë Bashkisë Vau Dejës i cili spjegon se jeni të pajisur me materialin të gjithë këshilltarët dhe se në mënyrë të shkurtrë flet për realizimin e të ardhurave, shpenzimet, keto sipas zërave dhe programeve të Buxhetit të Bashkisë. Gjithashtu spjegohet edhe realizimi sipas funksioneve që ushtron Bahkia, projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe të huaj.

Këshilltarët nuk kishin pyetje rreth raportit të monitorimit për periudhën Janar-Dhjetor 2023.

Pika 9. Të ndryshme.

Z.Ervis Shimaj fton këshilltarët për të shtruar problemet që ato kanë hasur gjatë kësaj kohe.

Z.Aleko Dodani-këshilltarë, nge problemin e pastrimit të mbeturinave në hyrje të qytetit të kryqëzimi i unazës, ku mbeturinat nuk mblidhen çdo ditë dhe për këtë arsye aty mblidhen shumë mbeturina, kërkoj që pastrimi të bëhet çdo ditë.

Z.Gjovalin Zefi- Zv/Kryetar i Bashkisë premton se do të merren masa dhe ky shërbim do të ofrohet çdo ditë.

Z. Martin Mardoda- këshilltarë, nge problemin e rruges Kaç-Naraç i cili kërkon që të nderhyhet nga ana e Bashkisë për mirëmbajtjen e këtij segmenti rrugor të pakten me inerte sepse degradimi i rruges çon në krijimin e aksidenteve.

Znj.Leonora Prenga – këshilltare kërkon që oborri i shkollës së mesme Hajmel të shtrohet me beton sepse aktualisht është në gjendje shumë të keqe dhe krijon probleme për nxënësit.

Z.Gjovalin Zefi premton se do bëhet e mundur ndërhyrja dhe do të sistemohet oborri i shkollës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës e datës 27.03.2024 deklarohet e mbyllur nga kryetari këshillit pasi këshilltarët nuk kishin diskutime tjera.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

Feris Sh'...
Franga K...
Frano K...
Iskender K...
Nelu Tep...
Besmir K...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

Listë prezenca e anëtarëve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për mbledhjen e rradhës Mars 2024.

Nr.	Emër	Mbiemër	Prezenca
1	Marin	Dodaj	
2	Gjovana	Corri	
3	Pjeter	Lleshi	
4	Rregjinë	Shelqetja	
5	Florin	Tanushi	
6	Vijoleta	Markolaj	
7	Ferdinand	Fusha	
8	Mark	Bisha	
9	Paola	Pleshaj	
10	Franga	Kola	
11	Kastriot	Shkjau	
12	Leonora	Prenga	
13	Neki	Kapllanaj	
14	Arsen	Mehmeti	
15	Roberto	Trushi	
16	Frano	Prenga	Roberto Trushi
17	Albina	Livadhi	
18	Ervis	Shimaj	
19	Kristjana	Kovaçi	
20	Rita	Preçi	
21	Aleko	Dodani	
22	Vjollcë	Zagani	
23	Martin	Mardoda	
24	Mirela	Vasija	
25	Ermir	Tahiri	
26	Ornela	Lleshi	
27	Besmir	Kapaj	
28	Gjon	Marku	
29	Meliha	Zyberaj	
30	Samed	Hasmegaj	

SEKRETARI KËSHILLIT

ARDIAN ÇELEPIJA

